



Npi – 01/120 datë: 03.04.2025

Bazuar në nenin 12.2 shkronja (c) dhe 40.2 shkronja (g) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008); Neneve 10 deri 22 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049; Udhëzimin Administrativ të (MSH) Nr. 03/2024 për bashkë pagesat për shërbimet shëndetësore; Rregulloren e MAPL-së Nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e Akteve të Komunës; Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 date 03.09.2008; Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa Npi – 01/118 datë:01.04.2025; Si dhe duke marrë për bazë Rekomandimin e MSH – Nr.05-1376 dt.25.02.2025 për Rishqyrtimin e Rregullores për Taksa Tarifa dhe Gjoha për vitin 2025. Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e rregullt, të mbajtur më datën: 03.04.2025, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN KOMUNALE PËR TAKSA, TARIFA DHE GJOBA PËR VITIN 2025

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e -III- të rregullt për vitin 2025, të mbajtur më: 03.04.2025, unanimisht miratoi ndryshimet në Rregulloren Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2025, Npi-01/23 dt. 27.01.2025, si vijon:

1. Fshihen nga Rregullorja Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2025, Npi – 01/23, të datës 27.01.2025, këto nene si vijon:

- Neni 10.2.5 Medikamenti nga lista esenciale, ofruar në barnatoren publike0.30 €
- Neni 10.2.14 Dhënja e injeksionit Intra muskular në shtëpi, përpos në rastet emergjente1.00 €
- Neni 10.2.15 Dhënja e injeksionit Intra venoz në shtëpi, përpos në rastet emergjente1.00 €
- Neni 10.2.18 Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ për Çertifikatat Shëndetësore Nr.04/2013, bëhet lëshimi i Çertifikatave të shëndetësore në Kujdesin Primar15.00 €

2. Është bërë harmonizimi i neneve 10.2.22 dhe 10.2.25 me U.A. Nr.03/2024 si vijon:

- Neni 10.2.22 RTG i dhëmbit(nga 1.50€ në 1.00 €)
- Neni 10.2.25 Shërimi biologjik i dhëmbit me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë)(nga 5 € në 4.00 €)

II

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në evidencën e protokolit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

III

Rregullorja dhe Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi